

Karta e apostollit Pavël mbë Kollossianëtë.

Krye 1.

- 1 Pavli, apostoll i Jisu Krishtit me anë të dashurimit të Perëndisë, edhe Timotheu vëllaj, Mbë shënjtorëtë edhe mbë vëllezëritë besëtarë mbë Krishtinë që janë ndë Kollossë; hir *qoftë* mbë ju edhe paqtim prej Perëndisë, Atit t'ënë, edhe prej Zotit Jisu Krisht.
- 3 I falemi ndersë Perëndisë edhe Atit të Zotit t'ënë Jisu Krisht, dyke falurë përherë
- 4 për ju, Passi dëgjuamë për besënë t'uaj mbë Krishtinë, edhe për dashurinë që kini mbë gjithë shënjtorëtë, Për shpresënë që ruhetë për ju ndë qiejt, të-cilënë e keni dëgjuarë që përpara ndë fjalët të së-vërtetës së ungjillit,
- 6 Që erdhi mbë ju, sikundrë edhe mbë gjithë botënë; edhe bje pemë, sikundrë edhe mbë ju, që mb'atë ditë që dëgjuat' edhe
- 7 njohtë hirin' e Perëndisë me të-vërtetë; Si-

- kundrë edhe e mësuarë nga Epafraj, nga idashuri bashkë-shërbëtori ynë, i-cili është për
- 8 ju shërbëtuat besëtar i Krishtit; I-cili edhe na dëfteu dashurinë t'uaj ndë Frymët.
 - 9 Përandaj edhe neve, që mb'atë ditë që dëgjuamë, nukë pushojmë dyke falurë për ju, edhe dyke luturë që të mbusheni prej të-njohurit të dashurimit t'ati me çdo urtësi e kupëtim
 - 10 shpirti; Që të ecëni sikundrë vëjen për Zotinë, për të pëlqyerë *ati* mbë të-gjitha, dyke sjellë pemë mbë çdo punë të-mirë, edhe dyke
 - 11 urriturë nde të-njohurit të Perëndisë; Dyke uforcuarë me çdo farë fuqie, pas pushtetit të lavdis' s'ati, për çdo durim e zëmërë
 - 12 të-gjerë me gëzim; Dyke falurë ndersë Atit, i-cili na bëri të-vëjejturë të kemi pjesë ndë
 - 13 trashëgimt të shënjtorëvevë ndë dritët; I-cili na shpëtoj nga pushteti i errësirësë, edhe na pruri ndë mbretërit të Birit të dashurisë së
 - 14 ti; Mbë të-cilinë kemi çpërblimnë me anë të
 - 15 gjakut t'ati, ndjesën' e fajevet; I-cili është shëmbëlles' e të-padukurit Perëndi, i-parëllinduri i gjithë kriesësë; Sepse me anë t'ati ukriuanë të-gjitha, sa janë ndë qiejt edhe sa janë mbi dhet, të-dukurat' e të-padukuratë, a frone, a zotërinj, a urdhëra, a pushtete, të-gjitha janë kriuarë me anë t'ati edhe për atë;
 - 17 Edhe ay është përpara të-gjithave, edhe të-
 - 18 gjitha me anë t'ati qëndronjënë; Edhe ay është kryet' e trupit, të kishësë; ay është të-

nisuritë, i-parëinduri prej të-vdekurvet, që të bënetë ay i-parë mbë të-gjitha.

- 19 Sepse mb' atë i pëlqeu Atit të rrijë gjithë
20 të-mbushuritë, Edhe me anë t' ati të paqto-
një të-gjitha me vetëhen' e ti, dyke paqtuarë
me anë të gjakut të kryqit t' ati, me anë t' ati,
edhe ato që janë mbi dhet, edhe ato që janë
ndë qiejt.
- 21 Edhe ju, që ishitë njëherë të-huaj edhe
22 armiq nga mëndja me punërat' e-liga, Ndashti
u paqtoj *me Perëndinë* ndë trupt të mishit të
ti, me anë të vdekjesë, që t'u nxjerrë juve
përpara vetëhes' së ti shënjtorë e faqe-bar-
dhë e të-pafajshim, Ndë qëndrofshi ndë be-
sët të-themelosur' e të-patundurë, e të mos lu-
ani nga shpresa e ungjillit që dëgjuatë, i-
cili ulëçit mbë gjithë kriesënë që është ndënë
qiellt; të-cilit *ungjill* unë Pavli i ubëshë shër-
bëtuar.
- 24 Ndashti gëzonem ndë të-hequrat të mia
për ju, edhe mbush mungimet' e shtrëngime-
vet të Krishtit ndë misht t'im për trupin'e ati,
25 që është kisha; Së-cilësë unë i ubëshë shërbë-
tuar pas kujdesit të Perëndisë që m' udha
për ju, që të mbush *të-lëçiturit'* e fjalës' së
26 Perëndisë, Fshehësirënë që ishte fshehurë nga
jetët' e nga brezatë, edhe ndashti uçfaq mbë
27 shënjtorët' e ati; Ndë të-cilët Perëndia deshi
të tregonjë cila është pasja e lavdis' së kë-
saj fshehësire mbë kombetë, e-cila është Kri-

- 28 shti mbë ju, shpresa e lavdisë; Të-cilinë ne-
ve e lëçisëmë dyke këshilluarë çdo njeri,
edhe dyke mësuarë çdo njeri me çdo urtësi,
që t'a nxjerrëmë çdo njeri të-sosurë mbë Jisu
29 Krishtinë. Për këtë punë edhe mundonem,
dyke upërpjekurë pas vepërimit t' ati që ve-
përon tek unë me fuqi.

Krye 2.

- 1 Sepse dua t'a dini sa të-math të-përpje-
kurë kam për ju edhe për ata që janë ndë
Llaodhiqi, edhe për gjithë sa s' kanë parë
2 faqenë t' ime ndë mishit, Që të ngushllonenë
zëmërat' e atyreve, dyke ubashkuarë ndë da-
shuri, edhe mbë çdo farë pasjeje' të kupëti-
mit të-mbaruarë, që të njohënë fshehësirën'
3 e Perëndisë' edhe Atit edhe të Krishtit; Tek
i-cili janë fshehurë gjithë thesarët' e urtësis'
4 e të diturisë. Edhe e them këtë, që të mos
u gënjenjë juve ndonjë me fjalë të-gatuara.
5 Sepse ndonëse me trupinë nukë jam aty, po
me shpirtinë jam bashkë me ju, dyke ugëzu-
arë e dyke parë radhënë t' uaj, edhe të-pa-
tundurit' e besësë s' uaj mbë Krishtinë. Sikun-
drë pra e keni marrë Zotinë Jisu Krisht,
7 *kështu* ecëni mb' atë, Dyke pasurë rrënjë e
dyke undërtuarë mb' atë, edhe dyke uforcu-
arë ndë besët, sikundrë umësuarë, dyke te-
përuarë mb' atë me të-falurë ndersë.
8 Vështroni semos u gënjenë juve ndonjë

me anë të fillosofisë edhe të kobimit të-kotë,
 pas fjalëvet të-lëna prej njerësvet, pas sti-
 9 hiavet të botësë, e jo pas Krishtit. Sepse tek
 ay rri gjithë të-mbushurit' e hierisë trupërisht;
 10 Edhe jeni të-mbushurë tek ay, i-cili është
 11 kryet' e çdo urdhëri e e çdo pushteti; Mbë
 të-cilin' edhe urrëthpretë me rrethpresje që
 s' bënëte me dorë, dyke sveshurë trupin' e
 fajevet të mishit me anë të rrethpresjes' së
 12 Krishtit, Dyke ukallurë ndë varr bashkë me
 atë ndë pagëzimt, ndë të-cilët edhe ungjalltë
 bashkë me anë të besës' së vepëtimit të Pe-
 rëndisë, i-cili ngjalli atë prej të-vdekurvet.
 13 Edhe juve, tek ishitë të-vdekurë ndë fajet e
 ndë parrethpresjet të mishit t' uaj, u bëri të-
 gjallë bashkë me atë, dyke falurë juve gj-
 14 thë fajetë; *Edhe* dyke shuarë dorëshkronjën'
 e porosivet që ishte kundrë nesh, e-cila ish-
 te e-kundrejtë mbë ne, edhe këtë e hoqi nga
 15 mezi, dyke mbërthyerë atë mbë kryqt; Edhe
 passi i sveshi urdhërata' edhe pushtetetë, i
 turpëroj ndër sy, dyke thriamvepsurë mbi
 atë kundrë atyre.
 16 Letë mos u gjykonjë juve pra asndonjë,
 për të-ngrënë a për të-pirë, a për gjërëra që
 kanë të bëjnë me të-kremte a me hënë të-re,
 17 a me të-shëtuna; Të-cilatë janë hije të punë-
 ravet që kanë për të ardhurë, po trupi *është'*
 18 i Kristit. Asndonjë letë mos u shternjë juve
 bravurënë më faqe mëndjeje së-përunjurë e-

dhe feje t' ëngjejvet, dyke hyrë mbë pu-
 nëra që s'i ka parë, dyke fryturë vetëhenë
 19 mbë kot prej mëndjes' së mishit të ti, Edhe
 nukë mban kryetë, *Krishtinë*, prej të-cilit gj-
 thë trupi, dyke upërbajturë e dyke ulidhurë
 bashkë me anë të nyjevet e të bashkë-lidh-
 jevet, rritetë pas të-rriturit të Perëndisë.
 20 Ndë qoftë pra se vdiqtë bashkë me Krish-
 tinë nga stiqiat' e botësë, përse dyke rruarë
 21 ndë botët jeni ndënë urdhërata, (Mos zësh,
 22 mos ngjëronesh, mos pjekç me dorë, Të-ci-
 latë të-gjitha prishenë nga të-përndoruritë;)
 pas përosivet e pas mësimet të njerësvet?
 23 Të-cilatë dukenë se kanë dituri mbë feda-
 shje, mbë mëndje të-përunjurë e mbë të-mos-
 kursyerë të trupit, sepse s'kanë mbë ndonjë
 farë nderi mishinë për të kënaqur' atë.

Krye 3.

1 Ndë qoftë se ungjalltë bashkë me Krish-
 tinë, kërkoni ato që *janë* lart, ku Krishti është
 2 ndënjurë mbë të-djathtë të Perëndisë. Kini
 ndër mëntt ato që *janë* lart, jo ato që janë
 3 mbi dhet. Sepse vdiqtë, edhe jeta juaj është
 fshehurë bashkë me Krishtinë te Perëndia.
 4 Kur të çfaqetë Krishti, jeta jonë, atëhere edhe
 ju bashkë me atë dotë çfaqë ndë lavdi.
 5 Bëni pra të-vdekura anë't e trupit' tuaj që
 janë mbi dhet, kurvërinë, ndyrësirënë, zëmë-
 rën' e-keqe, dëshërimin' e-lik edhe lakmimnë,

- 6 që është idhullatri; Për të-cilatë *gjërëra* vjen zëmërat' e Perëndisë përmbi të bijt' e pabin-djesë; Ndë të-cilat edhe ju ectë njëherë, kur 8 rronitë ndër ato. Po ndashti hithni edhe ju të-gjitha *këto*, mërinë, zëmëratënë, të-ligënë, vllasfiminë, fjalët' e-ndyra prej gojësë s' uaj.
- 9 Mos thoni gënjeshtër njëri tjetrit, pasi sveshtë njerin' e-vjetërë bashkë me punërat' e ati,
- 10 Edhe veshtë të-rinë që përtërihetë mbë të-njohurë pas shëmbëllës' s'ati që e ka kriuarë;
- 11 Ku s'ka Grek e Judhe, rrethpresje e pa-rrethpresje, varvar, Sqith, shërbëtuar, të-lirë, po të-gjitha e mbë të gjitha *është* Krishti.
- 12 Vishni pra, si të-sgjedhurë të Perëndisë shënjtore edhe të-dashurë, zëmëra përdëllimeve, mirësi, mendje të-përunjturë, butësirë,
- 13 zëmërë të-gjerë; Dyke duruarë njëri tjetërinë, edhe dyke ndjerë njëri tjetërinë, ndë pastë ndonjë të-qarë kundërë ndonjë; sikundër edhe
- 14 Krishti u ndjeu juve, kështu edhe ju. Edhe përmbi gjithë këto *vishni* dashurinë, e-cila është bashkë-lidhja e qënjes' së-sosurë. Edhe paqtimi i Perëndisë letë mbretëronjë ndër zëmërat t'uaj, mbë të-cilin' edhe uthërrittë ndë një trup; edhe bëhi asish që e njohënë të-mirënë.
- 16 Fjal' e Perëndisë letë rrijë mbë ju e-pasurë me çdo farë diturie; mësoni e këshilloni njëri tjetërinë me psallma e me hymna e me kënkë shpirtërishte, dyke kënduarë me hir

- 17 ndë zëmërët t' uaj mbë Zotinë. Edhe çdo që të bëni me fjalë a me punë, të-gjitha *ti bëni* mb' emërë të Zotit Jisu, dyke falurë ndersë Perëndisë edhe Atit me anë t'ati.
- 18 Ju gratë, binduni burravet t' uaj, sikundër gjan mbë Zotinë.
- 16 Ju burratë, doni gratë *t'uaj*, edhe mos ini të-hidhurë tek ato.
- 20 Ju bijtë, binduni prindërvet t' uaj mbë të-gjitha; sepse këjo është e-pëlqyerë te Zoti.
- 21 Ju atëritë, mos i zëmëroni bijtë t' uaj, që të mos u likshtonetë zëmëra.
- 22 Ju shërbëtorëtë, binduni së-gjithash zotërinjvet *t'uaj* pas mishit, jo me të-shërbyerë *vetëmë* përpara syvet, si asish që *duanë* t'u pëlqenjënë njerësvet, po me mituri zëmëre,
- 23 dyke pasurë frikë nga Perëndia. Edhe çdo që bëni, prej shpirti puno-e-ni, posi Zotit, e jo
- 24 njerësve; Dyke diturë se prej Zotit keni për të marrë çpagimin' e trashëgimit; sepse Zotit
- 25 Krisht i shërbeni; Po ay që punon shtrëmbëri, dotë marrë çpagimin' e shtrëmbëris' së ti; sepse s' ka të-mbajturë anë.

Krye 4.

- 1 Ju zotërinjtë, ep-u-ni shërbëtorëvet *t'uaj* të-drejtënë edhe sa u bën, dyke diturë, se edhe ju keni Zot ndë qiej.
- 2 Qëndroni mbë të-falurit, dyke ndënjurë
- 3 sguarë nd' atë me të-falurë ndersë; Dyke fa-

- lurë ndë gjithatë kohë edhe për ne, që të na hapnjë Perëndia derë të fjalësë, që të flasëmë fshehësirën'e Krishtit, për të-cilënë edhe 4 jam lidhurë; Që t'a çfaq atë, sikundrë duhetë të flas.
- 5 Ecëni me urtësi mbë të-jashtësmitë, dyke 6 çpërblyerë kohënë. Fjala juaj letë jetë përherë me hir, me kripë ndrequrë, që të dini qysh duhetë t'i përgjigjeni gjithë-sicilit.
- 7 Gjithë punërat' e mia dot' u' a rrëfenjë juve Tiqiku, vëllaj i-dashurë, edhe punëtuar besëtar, edhe shërbëtuat bashkë me mua 8 mbë Zotinë; Të-cilinë e dërgova ndër ju për gjithë-këtë *punë*, që të marrë vesh punëratë t'uaj, edhe të ngushullonjë zëmëratë t'uaj;
- 9 Bashkë me Onisiminë, besëtarin' edhe të-dashurinë vëlla, i-cili është prej jush; ata dot' u rrëfenjëne juve gjithë të-këtushmetë.
- 10 U faletë juve me shëndet Aristarku robi bashkë me mua, edhe Marku, i nip' i Varnavësë, (për të-cilinë muartë porosira; ndë 11 arhtë te ju, prit-e-ni *me të-mirë*;) Edhe Jisuj që thuhetë Just, të-cilëtë janë nga rreth-presja; këta vetëmë janë bashkëpunëtorë të mi ndë mbretërit të Perëndisë, të-cilët' 12 ubënë tek unë ngushullim. U faletë juve me shëndet Epafraj që *është* prej jush, shërbëtuat i Krishtit, i-cili përpiketë për ju gjithënjë ndë të-falurat, që të qëndroni të-sosur' edhe të mbushurë mbë çdo dashurim të

- 13 Perëndisë. Sepse *unë* dëshmonj për atë, se i përvëlonetë shumë zëmëra për ju, edhe për ata që janë ndë Laodhiqi, edhe për ata që janë 14 ndë Hierapolë. U faletë me shëndet juve Lukaj, mjekësi i-dashurë, edhe Dhimaj.
- 15 Fal-u-ni me shëndet vëllezërvet që janë ndë Llaodhiqi, edhe Nimfajt edhe kishësë që 16 është ndë shtëpit t'ati. Edhe si të këndonetë karta ndër ju, bëni që të këndonetë edhe ndë kishët të Llaodhiqiasvet; që të këndoni edhe juve atë që *do'u dërgonetë* prej Llaodhiqisë. Edhe tho-i-ni Arqippit, Ki kujdes ndë shërbesët që more mbë Zotinë, që t'a mbushç atë.
- 18 Të-faluritë me shëndet *ushkrua* me dorë-në t'ime, të Pavlit. Kujtoni të-lidhurat' e mia. Hiri *qoftë* bashkë me ju. Amin.